REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR 2806 VENDIMI

# V E N D I M
## PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me daten 18.03. 2010, unë **Manjola Bejleri,** gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi **Korab Llazani** dhe dokumentacionin per regjistrimin si person juridik te organizates jofitimprurese me emertimin **"FEDERATA SHQIPTARE E BASKETBOLLIT"**

## K O N S T A T O V A:

Se kerkuesi **Korab Llazani,** ka paraqitur prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, kerkesen per regjistrimin person juridik te organizates jofitimprurese, me emertimin **"FEDERATA SHQIPTARE E BASKETBOLLIT**

Themeluesit e Federates jane: **Shoqata "ALFA BASKET ALBANIA", "SHOQATA SPORTIVE E BASKETBOLLIT –LUSHNJE", Shoqata "SHKODRA BASKET 1", Shoqata "SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË BASKETBOLLIT", Shoqata "TIRANA BASKETBOLL FEMRA", Shoqata "VALBONA BASKET"**

Selia e Federates eshte **ne Tirane, rruga "Brigada e VIII, Pallati i Pingulit, Hyrja 3, ap 1.**

Federata zhvillon veprimtarine e saj per nje kohezgjatje te papercaktuar.

Organet drejtuese te Federates jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Anetareve
- Presidenti
- Komiteti Drejtues
- Sekretari i Pergjithshem
- Komisionet

President eshte zgjedhur z **Avni Ponari,** i cili perfaqeson Federaten ne marredhenie me te tretet.

**Personi** i cili autorizohet te ndjeke ne emer te Federates te gjithe procedurat e nevojshme per regjistrimin si person juridik ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane eshte **Korab Llazani**

**Qellimi dhe pikesynimet e Federates**

Te zhvilloje, promovoje, kontrolloje dhe rregulloje aktivitetin basketbollistik dhe sportiv te anetareve te FSHB-se ne te gjitha format e tij e ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, ne perputhje me statutin.

Te organizoje Kampionatin Kombetar dhe Kupen e Shqiperise dhe te shpalle "ekipin kampion kombetar" dhe "ekipin fitues te Kupes se Shqiperise" ne sportin e basketbollit".

Te perfaqesoje Republiken e Shqiperise ne federatat dhe organizmat nderkombetare te basketbollit.

Te organizoje dhe drejtoje ekipet kombetare dhe te marre pjese ne veprimtarite sportive nderkombetare ose te autorizioje pjesemarrjen e anetareve te saj ne keto veprimtari.

Te organizoje ne Republiken e Shqiperise veprimtari sportive nderkombetare dhe te jape leje per organizimin e tyre nga / per anetaret e saj.

Te perfaqesoje kete sport ne organizatat sportive kombetare.

Asnje person juridik, privat ose publik nuk mund te marre nga kompetencat ekskluzive te FSHB-se, vetem nese ato i jane dhene zyrtarisht prej saj.

Ajo eshte nje organizate jofimprurese dhe joqeveritare.

**BURIMET FINANCIARE TE FEDERATES**

- Fondet shteterore te akorduara ne forme granti te parashikuara ne buxhetin e shtetit dhe te miratuara nga ministria pergjegjese per sportin.
- Kuotat vjetore te anetaresimit te anetareve te FSHB-se (te caktuara nga asambleja) te cilat kryhen sipas rregulloreve te brendshme qe e rregullojne kete marredhenie.
- Te ardhurat e krijuara nga marketingu i te drejtave televizive dhe reklamave per aktivitet nderkombetar te ekipeve kombetare qe gezon Federata Shqiptare e Basketbollit.
- Sponsorizimet, dhurimet, financimet nga shteti ne formen e investimeve dhe projekteve, si dhe burime te tjera te lejuara me ligj.
- Nga licencimi i trajnereve, sportisteve, gjyqtareve, mjekeve, vezhguesve, specialisteve, amatoreve.

Te ardhurat e realizuara nga Federata duhet te perdoren vetem per realizimin e veprimtarise qe parashikohen ne qellimin dhe objektivin e veprimtarise se parashikuar ne statut.
Sa me siper bazuar ne ligjin 8788 date 7.05.2001, çmoj se dokumentacioni i paraqitur eshte i plote, kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr.8788 date 07.05.2001 „Per organizata jo fitimprurese"si dhe Ligjit 8789 dt 07.05.2001"Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese".

**VENDOSA:**

Pranimin e kerkeses.
Regjistrimin si person juridik organizates jofitimprurese, me emertimin **"FEDERATA SHQIPTARE E BASKETBOLLIT"**
Themeluesit e Federates jane: **Shoqata "ALFA BASKET ALBANIA", "SHOQATA SPORTIVE E BASKETBOLLIT -LUSHNJE", Shoqata "SHKODRA BASKET 1", Shoqata "SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË BASKETBOLLIT", Shoqata "TIRANA BASKETBOLL FEMRA", Shoqata "VALBONA BASKET"**
Selia e Federates eshte **ne Tirane, rruga "Brigada e VIII, Pallati i Pingulit, Hyrja 3, ap 1.**
Federata zhvillon veprimtarine e saj per nje kohezgjatje te papercaktuar.
Organet drejtuese te Federates jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Anetareve
- Presidenti
- Komiteti Drejtues
- Sekretari i Pergjithshem
- Komisionet

President eshte zgjedhur z **Avni Ponari**, i cili perfaqeson Federaten ne marredhenie me te tretet.

**Personi** i cili autorizohet te ndjeke ne emer te Federates te gjithe procedurat e nevojshme per regjistrimin si person juridik ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane eshte **Korab Llazani**

**Qellimi dhe pikesynimet e Federates**

Te zhvilloje, promovoje, kontrolloje dhe rregulloje aktivitetin basketbollistik dhe sportiv te anetareve te FSHB-se ne te gjitha format e tij e ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, ne perputhje me statutin.

Te organizoje Kampionatin Kombetar dhe Kupen e Shqiperise dhe te shpalle "ekipin kampion kombetar" dhe "ekipin fitues te Kupes se Shqiperise" ne sportin e basketbollit".

Te perfaqesoje Republiken e Shqiperise ne federatat dhe organizmat nderkombetare te basketbollit.

Te organizoje dhe drejtoje ekipet kombetare dhe te marre pjese ne veprimtarite sportive nderkombetare ose te autorizioje pjesemarrjen e anetareve te saj ne keto veprimtari.

Te organizoje ne Republiken e Shqiperise veprimtari sportive nderkombetare dhe te jape leje per organizimin e tyre nga / per anetaret e saj.

Te perfaqesoje kete sport ne organizatat sportive kombetare.

Asnje person juridik, privat ose publik nuk mund te marre nga kompetencat ekskluzive te FSHB-se, vetem nese ato i jane dhene zyrtarisht prej saj.

Ajo eshte nje organizate jofimprurese dhe joqeveritare.

**BURIMET FINANCIARE TE FEDERATES**

- Fondet shteterore te akorduara ne forme granti te parashikuara ne buxhetin e shtetit dhe te miratuara nga ministria pergjegjese per sportin.
- Kuotat vjetore te anetaresimit te anetareve te FSHB-se (te caktuara nga asambleja) te cilat kryhen sipas rregulloreve te brendshme qe e rregullojne kete marredhenie.
- Te ardhurat e krijuara nga marketingu i te drejtave televizive dhe reklamave per aktivitet nderkombetar te ekipeve kombetare qe gezon Federata Shqiptare e Basketbollit.
- Sponsorizimet, dhurimet, financimet nga shteti ne formen e investimeve dhe projekteve, si dhe burime te tjera te lejuara me ligj.
- Nga licencimi i trajnereve, sportisteve, gjyqtareve, mjekeve, vezhguesve, specialisteve, amatoreve.

Te ardhurat e realizuara nga Federata duhet te perdoren vetem per realizimin e veprimtarise qe parashikohen ne qellimin dhe objektivin e veprimtarise se parashikuar ne statut.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

**GJYQTARE**

**Manjola Belleri**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE